

VENDIM
Nr. 41/2022

**PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT PËR DIASPORËN
DHE MIGRACIONIN NË PËRBËRJE TË KOMISIONIT
TË PËRHERSHËM PARLAMENTAR PËR POLITIKËN E JASHTME**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 19, pika 2, 21, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet Nënkomisioni për Diasporën dhe Migracionin në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Politikën e Jashtme.

II. Objekti dhe fusha e përgjegjësisë së këtij Nënkomisioni janë çështjet e diasporës dhe fenomenit migrator të Shqipërisë.

III. Nënkomisioni përbëhet nga 5 anëtarë si më poshtë:

1. Lavdrim Krrashi	kryetar	(PS);
2. Kreshnik Çollaku	zëvendëskryetar	(PD);
3. Etjen Xhafaj	anëtar	(PS);
4. Hatixhe Konomi	anëtare	(PS);
5. Tomor Alizoti	anëtar	(PD).

Anëtarë zëvendësues:

1. Besian Ajazi	anëtar	(PS);
2. Petro Koçi	anëtar	(PS);
3. Greta Bardeli	anëtar	(PD).

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARE
Ermonela Felaj (Valikaj)

Miratuar në datën 30.5.2022.